

FM Stereo Marrës FM/AM

Udhëzimet e përdorimit

PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit, mos mbuloni hapësirën e ajrimit me gazeta, mbulesa tavoline, perde, etj. Mos vendosni mbi aparaturë burime me flakë të pambrojtur siç janë qirinjtë e ndezur.

Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një mobilie inkaso.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi aparaturë nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidhjeni njësinë me një prizë lehtësisht të arritshme rryme të drejtpërdrejtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos ekspozoni bateritë ose aparaturën me bateri të instaluar ndaj nxehtësisë së tepruar siç janë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme me to.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën e rrymës së drejtpërdrejtë, edhe nëse njësia vetë është e fikur.

Presioni i tepruar i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.



Ky simbol përdoret për të njoftuar përdoruesin mbi praninë e sipërfaqes së nxehtë, që mund të jetë e nxehtë nëse preket gjatë funksionimit normal.

Për klientët në Shtetet e Bashkuara

Regjistri i zotëruesit

Modeli dhe numrat serialë ndodhen në pjesën e pasme të njësisë. Regjistrojini këto numra në hapësirën e dhënë më poshtë. Referojuni atyre sa herë që kontaktoni me shitësin tuaj Sony në lidhje me këtë produkt.

Numri i modelit _____ Numri i serisë _____



Ky simbol përdoret për të njoftuar përdoruesin mbi praninë e ndonjë "rryme të rrezikshme" të paizoluara brenda produktit që mund të jetë e një përmase të mjaftueshme për të përbërë rrezik goditjeje elektrike për personat.



Ky simbol përdoret për të njoftuar përdoruesin mbi praninë e udhëzimeve të rëndësishme të përdorimit dhe mirëmbajtjes (shërbimit) në broshurat që shoqërojnë pajisjen.

Udhëzime të rëndësishme mbi sigurinë

- 1) Lexojini këto udhëzime.
- 2) Ruajini këto udhëzime.
- 3) Tregoni kujdes për të gjitha paralajmërimet.
- 4) Ndiqini të gjitha udhëzimet.
- 5) Mos e përdorni këtë aparaturë pranë ujit.
- 6) Pastrojini vetëm me pëlthurë të thatë.
- 7) Mos bllokoni hapësirat e ajrimit. Instalohjeni në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- 8) Mos e instaloni pranë burimeve nxehtësie siç janë radiatorët, regjistruerit e nxehtësisë, sobat ose pajisje të tjera (duke përfshirë edhe amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- 9) Mos shpërfillni qëllimin e sigurisë së spinës së polarizuar ose të tokëzuar. Një spinë e polarizuar ka dy kunjat ku njëra është më e gjatë se tjetra. Një spinë e tokëzuar ka dy kunjat dhe një të tretë për tokëzim. Kunji i gjerë ose kunji i tretë ofrohen për sigurinë tuaj. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektrikist për zëvendësimin e prizës së vjetër.
- 10) Mbrojeni kordonin e rrymës nga shkelja ose përthyerja veçanërisht te spinat, prizat, si dhe te pika ku ato dalin nga aparatura.
- 11) Përdorni vetëm pjesët/aksesorët e specifikuar nga prodhuesi.

12) Përdoreni vetëm me tryezën me rrota, portmanonë, këmbalecin, mbajtësen ose tavolinën e specifikuar nga prodhuesi, ose që shitet së bashku me aparaturën. Kur përdoret tryezë me rrota, tregoni kujdes gjatë lëvizjes së kombinimit tryezë me rrota/aparaturë për të shmangur lëndimet nga përmbysja.



13) Shkëputeni këtë aparaturë nga priza gjatë stuhive me rrufe ose kur nuk përdoret për periudha të gjata kohore.

14) Për të gjitha shërbimet drejtojeni personelit të kualifikuar të shërbimit. Kërkohet shërbim kur aparatura është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si p.sh. nëse është dëmtuar kordoni i furnizimit me rrymë ose priza, nëse mbi aparaturë janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte, nëse aparatura është ekspozuar ndaj shiut ose lagështirës, nëse nuk punon siç duhet ose nëse është rrëzuar.

Deklarata e mëposhtme FCC aplikohet vetëm për versionin e këtij modele të prodhuar për shitje në SH.B.A. Versionet e tjera mund të mos jenë konform rregulloreve teknike FCC.

SHËNIM:

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve për pajisjet dixhitale të Klasit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Këto limite janë përcaktuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim në shtëpi. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të përhapë energji të frekuencave radio dhe mund të shkaktojë interferenca të dëmshme me komunikimet radio nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me udhëzimet. Megjithatë, nuk garantohet që nuk do të ndodhë interferencë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme në marrjen radiofonike ose televizive, që mund të përcaktohet duke ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpiqet të korrigjojë interferencën përmes një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Të riorientohet ose zhvendoset antena marrëse.
- Të rritet hapësira ndarëse mes pajisjes dhe marrësit.

- Të lidhet pajisja në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai ku është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose një teknik televizori/radioje me përvojë për asistencë.

KUJDES

Kini kujdes që ndryshimet apo modifikimet që nuk janë të miratuara shprehimisht në këtë manual të mos zhvlerësojnë të drejtën tuaj për të përdorur këtë pajisje.

Për të reduktuar rrezikun e goditjes elektrike, kordoni i altoparlantit duhet të lidhet me aparaturën dhe altoparlantët në përputhje me udhëzimet e mëposhtme.

- 1) Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë nga RRJETI ELEKTRIK.
- 2) Zhvishni 10 deri 15 mm nga izolimi i telit të kordonit të altoparlantit.
- 3) Lidhni me kujdes kordonin e altoparlantit me aparaturën dhe altoparlantët, duke mos e prekur me dorë pjesën e brendshme të kordonit të altoparlantit. Shkëputni gjithashtu kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë nga RRJETI ELEKTRIK përpara se të shkëputni kordonin e altoparlantit nga aparatura dhe altoparlantët.

Për klientët në Evropë



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0.0005% zhivë ose 0.004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi.

Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen Direktivat e BE-së.

Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurinë e produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, ju lutemi referojuni adresave që jepen në dokumentet e veçanta të shërbimit ose garancisë.

Mbi këtë manual

- Udhëzimet në këtë ky manual janë për modelin STR-DH130. Numri i modelit ndodhet në këndin e djathtë të poshtëm të panelit të përparmë. Ilustrimet e përdorura në këtë manual janë të modelit për Evropën, dhe mund të jenë ndryshe nga modeli juaj. Çdo ndryshim në funksionim shënohet në manual si “Vetëm modelet evropiane”.
- Udhëzimet në këtë manual përshkruajnë funksionimin e marrësit me telekomandën e dhënë. Ju mund të përdorni gjithashtu edhe butonat ose çelësat në marrës nëse kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm me ato në telekomandë.

Pasqyra e lëndës

Mbi këtë manual	4
Aksesorët e dhënë.....	6
Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve.....	7
Fillimi.....	13

Lidhjet

1: Instalimi i altoparlantëve.....	13
2: Lidhja e altoparlantëve.....	14
3: Lidhja e pajisjes audio/video.....	14
4: Lidhja e antenave (ajrore).....	17
5: Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).....	18

Përgatitja e marrësit

Nisja e marrësit	18
Zgjedhja e sistemit të altoparlantëve.....	19
Rregullimi i tonit	19

Funksionet bazë

Riprodhimi	20
Paraqitja e informacionit në panelin e ekranit	21
Regjistrimi duke përdorur marrësin.....	22

Funksionet e sintonizuesit

Dëgjimi i radios FM/AM.....	22
Paravendosja e stacioneve të radios FM/AM (Sintonizimi i paravendosur)	24
Marrja e transmetimeve RDS	26
(Vetëm modeli evropian)	

Funksionet e menysë

Përdorimi i menysë së cilësimeve.....	26
---------------------------------------	----

Përdorimi i telekomandës

Ripërcaktimi i butonit të hyrjes.....	27
Ripërcaktimi i butonave të hyrjes.....	28

Informacion shtesë


Masat paraprake	29
Zgjidhja e problemeve.....	30
Specifikimet.....	32
Indeksi.....	34

Aksesorët e dhënë


- Udhëzimet e përdorimit (ky manual)
- Udhëzuesi i shpejtë i konfigurimit
- Antena FM me tel (ajrore) (1)



- Antena AM në formë kornize (ajrore) (1)



- Telekomanda (RM-AAU130) (1)




- Bateri R6 (përmasa AA) (2)



Futja e baterive në telekomandë

Futni dy bateri R6 (përmasa AA) (të dhëna) në mënyrë që ⊕ dhe ⊖ në bateri të përputhen me diagramin brenda folesë së baterisë së telekomandës.




Shënime


- Mos e lini telekomandën në një vend shumë të nxehtë ose shumë me lagështirë.
- Mos përdorni bateritë e reja së bashku me të vjetrat.
- Mos përzieni bateri me mangan me lloje të tjera baterish.
- Mos e ekspozoni sensorin e telekomandës ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose aparaturave që lëshojnë dritë. Duke vepruar kështu mund të shkaktoni keqfunksionim.
- Nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë kohe, hiqni bateritë për të shmangur dëmtimet e mundshme nga rrjedhja dhe gërryerja e baterive.
- Kur zëvendësoni ose hiqni bateritë, butonat në telekomandë mund të rivendosen në cilësimet e parazgjedhjes. Nëse ndodh kjo, përcaktoni edhe një herë butonat e hyrjes (faqe 27).
- Kur marrësi nuk i përgjigjet më telekomandës, zëvendësoni të gjitha bateritë me të reja.

Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve

Paneli i përparmë



Treguesit në panelin e ekranit



1 I/O (ndezur/në gatishmëri) (faqe 18, 24)

2 SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) (faqe 14, 19)

3 INPUT SELECTOR (faqe 20, 22 – 25)

4 Paneli i ekranit

5 Sensori i telekomandës
Merr sinjal nga telekomanda.

6 MASTER VOLUME (faqe 20)

7 MUTING (faqe 20)

8 DIMMER
Rregullon ndriçimin e panelit të ekranit në 3 nivele.

9 DISPLAY (faqe 21)

10 BASS +/-, TREBLE +/- (faqe 19)

11 TUNING MODE, TUNING +/-, MEMORY/ENTER (faqe 23, 25)

12 FM MODE (faqe 23)

13 Foleja PHONES (faqe 30)

14 SP A/SP B

Ndizet sipas sistemit të altoparlantëve që përdoret (faqe 19). Megjithatë, këta tregues nuk ndizen nëse është e fikur dalja e altoparlantit ose nëse janë lidhur kufjet.

15 SLEEP

Ndizet kur aktivizohet kohëmatësi i fjetjes (faqe 11).

16 Treguesit e sintonizimit

Ndizet kur marrësi sintonizohet në një stacion radioje.

MEMORY

Është aktivizuar një funksion memorieje, si p.sh. memoria e paravendosur (faqe 24), etj.

RDS (Vetëm modeli evropian)

Sintonizuar në një stacion radioje me shërbimet RDS.

MONO

Transmetim mono


ST

Transmetim stereo






Numri i stacionit të paravendosur (Numri do të ndryshojë sipas stacionit të paravendosur që zgjidhni.)



Paneli i pasmë



1 Përzgjedhja e sinjalit audio (faqe 14, 16)

-  I bardhë (L) Foletë AUDIO IN/OUT
-  I kuq (R)
-  Foleja PORTABLE IN

2 Seksioni ANTENNA (faqe 17)

-  Foleja FM ANTENNA
-  Terminalet AM ANTENNA


3 Seksioni SPEAKERS (faqe 14)



Telekomanda

Përdorni telekomandën e dhënë për të përdorur këtë marrës dhe pajisjet e tjera. Telekomanda është caktuar për të përdorur pajisjet audio/video Sony. Mund të përcaktoni butonin e hyrjes sipas pajisjeve të lidhura me marrësin tuaj (faqe 27).

RM-AAU130



Për të kontrolluar marrësin

- 2 **I/O* (ndezur/në gatishmëri)**
Ndez marrësin ose e vendos atë në modalitet gatishmërie.
- 3 **Butonat e hyrjes**
Përzgjedh pajisjen që dëshironi të përdorni. Kur shtypni një nga butonat e hyrjes, marrësi ndizet. Butonat janë të caktuar për të kontrolluar pajisjet Sony.
- 7 **D.TUNING**
Kalon direkt në modalitetin e sintonizimit.
- 8 **ENTER/MEMORY**
Ruan një stacion gjatë përdorimit të sintonizuesit.
- 9 **AMP MENU**
Shfaq menynë për të përdorur marrësin.
- 11 **MUTING**
Mbyll përkohësisht zërin. Shtypni butonin sërish për të rikthyer zërin.
- 12 **MASTER VOL +**/-**
Rregullon nivelin e volumnit të të gjithë altoparlantëve njëkohësisht.
- 14 **TUNING +/-**
Skanon një stacion.
PRESET +/-
Zgjedh stacionet e paravendosura.
FM MODE
Zgjedh marrjen FM mono ose stereo.
- 16 **RETURN/EXIT**
Kthehet në menynë e mëparshme.
- 17 **◀/▶, ▲/▼, ◀/▶**
Shtypni ▲/▼/◀/▶ për të zgjedhur cilësimet, më pas shtypni ◀/▶ për të vendosur/konfirmuar përzgjedhjen.
- 18 **DISPLAY**
Paraqet informacion në panelin e ekranit.
- 20 **Butonat e numrave****
Paravendos ose sintonizon te stacionet e paravendosura.

22 SLEEP

Vendos marrësin të fiket automatikisht në një kohë të specifikuar.
Sa herë që shtypni këtë buton, ekrani ndryshon në mënyrë ciklike si më poshtë.

0-30-00 → 1-00-00 → 1-30-00 → 2-00-00 → OFF

Kur është në përdorim kohëmatësi i fjetjes, treguesi "SLEEP" ndizet në panelin e ekranit.

Këshillë


Për të kontrolluar kohën e mbetur përpara se marrësi të fiket, shtypni SLEEP. Koha e mbetur shfaqet në panelin e ekranit. Nëse shtypni sërish SLEEP, do të anulohet kohëmatësi i fjetjes.

- * Nëse shtypni AV I/⏻ (1) dhe I/⏻ (2) njëkohësisht, marrësi dhe pajisja e lidhur do të fiket (SYSTEM STANDBY). Funkzioni i AV I/⏻ (1) ndryshon automatikisht sa herë që shtypni butonat e hyrjes (3).
- ** Butonat e numri 5, MASTER VOL +/TV VOL +, dhe ► kanë pika të prekshme. Përdorini pikat e prekshme si referenca kur përdorni marrësin.

Për të kontrolluar një televizor Sony

Mbani shtypur TV (15), më pas shtypni butonin me ngjyrë portokalli për të zgjedhur funksionin që dëshironi.

Shembull: Mbani shtypur TV (15), më pas shtypni TV CH +.



1 TV I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)

Fik ose ndez televizorin.

8 ENTER/MEMORY

Fut për zgjedhjet.

10 TOOLS/OPTIONS

Shfaq opsionet e funksionit të televizorit.

11 MUTING

Aktivizon funksionin e heshtjes së televizorit.

12 TV VOL +*/-/

Rregullon volumnin e televizorit.

13 MENU/HOME

Shfaq meny të televizorit.

14 TV CH +/-

Skanon kanalet e paravendosura televizive.

16 RETURN/EXIT ↶

Kthehet në meny në e mëparshme të televizorit.

18 DISPLAY

Shfaq informacionin që lidhet me programin aktual televiziv.

19 -/-

Zgjedh modalitetin e hyrjes së kanalit televiziv.

>10/-

Zgjedh numrat e kanaleve të terminalit të televizionit kabllor dixhital.

Për shembull, për të zgjedhur 2.1, shtypni 2, >10/- dhe 1.

20 Butonat e numrave**

Zgjedh kanalet televizive.

23 TV INPUT

Zgjedh sinjalin e hyrjes.

- * Nëse shtypni AV I/⏻ (1) dhe I/⏻ (2) njëkohësisht, marrësi dhe pajisja e lidhur do të fiket (SYSTEM STANDBY). Funkzioni i AV I/⏻ (1) ndryshon automatikisht sa herë që shtypni butonat e hyrjes (3).

** Butonat e numri 5, MASTER VOL +/TV VOL +, dhe ► kanë pika të prekshme. Përdorini pikat e prekshme si referenca kur përdorni marrësin.

Për të kontrolluar pajisje të tjera Sony

Emri	Luajtës Blu-ray Disc, DVD	Sintonizues satelitor, sintonizues televizioni kabllor	VCR	Luajtës CD	Luajtës MD, luajtës kasetash
1 AV I/⏻ ^{a)}	Energjia	Energjia	Energjia	Energjia	Energjia ^{c)}
5 POP UP/MENU	Menyja	-	-	-	-
6 TOP MENU	Udhëzuesi në ekran	-	-	-	-
8 ENTER/MEMORY	Fut	Fut	Fut	Fut	-
10 TOOLS/OPTIONS	Menyja e opsioneve	Menyja e opsioneve	-	-	-
13 MENU/HOME	Menyja	Menyja	Menyja	-	-
14 ⏮/▶▶	Kapërce pjesën	Zgjidh kanal	Kërko indeksin	Kapërce pjesën	Kapërce pjesën
REPLAY ◀-/ADVANCE ▶▶	Përsërit luajtjen, përshpejto para	-	Përsërit luajtjen, përshpejto para	-	-
◀◀/▶▶	Kërko përpara, prapa	-	Përshpejto para, kthe prapa	Përshpejto para, kthe prapa	Përshpejto para, kthe prapa
▶ ^{b)}	Luaj	-	Luaj	Luaj	Luaj
	Pauzë	-	Pauzë	Pauzë	Pauzë
■	Ndal	-	Ndal	Ndal	Ndal
16 RETURN/EXIT ↵	Kthehu	Kthehu, dil	-	-	-
17 ⊕	Fut	Fut	Fut	Fut	Fut ^{c)}
⬆/⬇/⬅/➡	Zgjidh	Zgjidh	Zgjidh	-	-
18 DISPLAY	Ekrani	Ekrani	Ekrani	Ekrani	Ekrani ^{c)}
19 -/-	-	-	-	-	-
>10/-	-	(.)pikë ^{d)}	Pjesa > 10	Pjesa > 10	-
CLEAR	Pastro	Pastro	-	-	-
20 Butonat e numrave ^{b)}	Pjesa	Kanali	Kanali	Pjesa	Pjesa ^{c)}

a) Nëse shtypni AV I/⏻ (1) dhe I/⏻ (2)

njëkohësisht, marrësi dhe pajisja e lidhur do të fiket (SYSTEM STANDBY).

Funksioni i AV I/⏻ (1) ndryshon automatikisht sa herë që shtypni butonat e hyrjes (3).

b) Butonat e numri 5, MASTER VOL +/TV VOL +, dhe ▶ kanë pika të prekshme. Përdorini pikat e prekshme si referenca kur përdorni marrësin.

c) Vetëm për luajtës MD.

d) Për shembull, për të zgjedhur 2.1, shtypni 2, >10/• dhe 1.

Shënime

- Shpjegimet e mësipërme kanë për qëllim të shërbejnë si shembuj.
- Në varësi të modelit të pajisjes së lidhur, disa funksione të shpjeguara në këtë paragraf mund të mos funksionojnë me telekomandën e dhënë.

Fillimi

Ju mund të shijoni pajisjet tuaja audio/video të lidhura me marrësin duke ndjekur hapat e thjeshtë të mëposhtëm.

**Instalimi dhe lidhja e altoparlantëve
(faqe 13, 14)**



**Lidhja e pajisjes audio/video
(faqe 14, 16)**



Përgatitja e marrësit

Shihni “5: Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)” (faqe 18) dhe “Nisja e marrësit” (faqe 18).




**Zgjedhja e sistemit të altoparlantëve
(faqe 19)**

Lidhjet

1: Instalimi i altoparlantëve


Ky marrës ju lejon të përdorni një sistem kanalesh 2.0.

Shembull i konfigurimit të sistemit të altoparlantëve



2: Lidhja e altoparantëve

Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).




A Kordonët e altoparantëve (nuk jepen)

* Nëse keni një sistem shtesë altoparantësh, lidhini ato me терминалет SPEAKERS B. Mund të zgjidhni altoparantët që dëshironi të përdorni me butonin SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) të marrësi (faqe 19).

3: Lidhja e pajisjes audio/video

Lidhja e pajisjes audio

Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).



- A Kordoni audio (nuk jepet)
- B Kordon fonie me fole për kufje stereo (nuk jepet)

* Nëse dëshironi të regjistroni, duhet të bëni këtë lidhje (faqe 22).

Shënime


- Kur dëgjoni një pajisje të lidhur me folenë PORTABLE IN, zëri mund të dalë i distortuar ose i shkëputur. Ky nuk është keqfunksionim dhe do të varet nga pajisja e lidhur.
- Nëse zëri nga pajisja e lidhur me folenë PORTABLE IN është shumë i butë, mund të ngrini nivelin e volumit. Megjithatë, përpara se të kaloni në hyrjen tjetër, sigurohuni që të reduktoni nivelin e volumit për të shmangur dëmtimin e altoparlantit.

Shënime

- Cilësimi i parazgjedhur për butonat e hyrjes BD/DVD dhe VIDEO në telekomandë janë si më poshtë:
BD/DVD: Luajtës Blu-ray Disc
VIDEO: VCR
Sigurohuni që të ndryshoni cilësimin e parazgjedhur të butonit të hyrjes BD/DVD (dhe VIDEO) në mënyrë që të përdorni butonin për të kontrolluar luajtësin DVD (dhe regjistruetin DVD). Për detaje shihni “Ripërcaktimi i butonit të hyrjes” (faqe 27).
- Gjithashtu mund të rriemërtoni hyrjen BD/DVD dhe VIDEO në mënyrë që të shfaqen në panelin e ekranit të marrësit. Për detaje shihni “Emërtimi i hyrjeve” (faqe 20).

4: Lidhja e antenave (ajrore)

Përpara lidhjes së antenave (ajrore), sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).




Shënime

- Për të parandaluar marrjen e zhurmave, mbajeni antenën AM në formë kornize (ajrore) larg nga marrësi dhe pajisjet e tjera.
- Sigurohuni që të zgjatni plotësisht antenën FM me tel (ajrore).
- Pasi të lidhni antenën FM me tel (ajrore), mbajeni atë sa më horizontalisht që të jetë e mundur.

5: Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)

Lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) me një prizë muri.


Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)



Përgatitja e marrësit

Nisja e marrësit

Përpara se të përdornit marrësin për herë të parë, nisni marrësin duke kryer procedurën e mëposhtme. Kjo procedurë mund të përdoret gjithashtu për të rikthyer aparaturën në cilësimet e fabrikës. Sigurohuni që të përdorni butonat në marrës për të kryer këtë veprim.



1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.

2 Mbani shtypur I/⏻ për 5 sekonda.


NË panelin e ekranit shfaqet "CLEARING" për një farë kohe, më pas ajo bëhet "CLEARED".

Ndryshimet ose përshtatjet që i janë bërë cilësimeve, tani rikthehen në cilësimet e parazgjedhura.

Zgjedhja e sistemit të altoparlantëve

Ju mund të zgjidhni altoparlantët që dëshironi të përdorni, nëse keni lidhur altoparlantët me terminalet SPEAKERS **A** dhe **B**. Sigurohuni që të përdorni butonat në marrës për të kryer këtë veprim.

SPEAKERS (OFF/A/B/A+B)



Shtypni SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur sistemin e altoparlantëve që dëshironi të përdorni.

Për të zgjedhur	Ndizet
Altoperlantët e lidhur me terminalet SPEAKERS A	SP A
Altoperlantët e lidhur me terminalet SPEAKERS B	SP B
Altoperlantët e lidhur me të dyja terminalet SPEAKERS A dhe B (lidhje paralele)	SP A SP B

Për të fikur radion daljen e altoparlantit


Shtypni SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) në mënyrë të përsëritur derisa të mos jenë ndezur treguesit "SP A" dhe "SP B" në ekran.

Shënim

Ju nuk mund të ndizni sistemin e altoparlantëve duke shtypur SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) kur janë lidhur kufjet.

Rregullimi i tonit

Ju mund të rregulloni cilësinë e tonit të altoparlantëve.




Shtypni TREBLE + ose TREBLE – në mënyrë të përsëritur për të rregulluar nivelin e zërit soprano.

Shtypni BASS + ose BASS – në mënyrë të përsëritur për të rregulluar nivelin e zërit bas.

Ju mund të rregulloni nga -10 dB deri +10 dB me hapa nga 1 dB.

Cilësimi fillestar është 0 dB.

Riprodhimi



- 1 Ndizni pajisjen e lidhur.**
- 2 Ndizni marrësin.**
- 3 Shtypni butonin e hyrjes që korrespondon me pajisjen që dëshironi.**

Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.
Hyryja e zgjedhur shfaqet në panelin e ekranit.

Shënim

Kur shtypni TUNER, shfaqet për një farë kohe “FM TUNER” ose “AM TUNER”, më pas shfaqet frekuenca në panelin e ekranit.

- 4 Riprodhoni burimin.**
- 5 Shtypni MASTER VOL +/- për të rregulluar volumnin.**

Mund të përdorni gjithashtu MASTER VOLUME te marrësi.

Për të aktivizuar funksionin e heshtjes së televizorit

Shtypni MUTING.

Funksioni i heshtjes do të anulohet kur veproni si më poshtë.

- Shtypni sërish butonin.
- Rrisni volumnin.
- Fikni marrësin.

Për të shmangur dëmtimin e altoparantëve

Përpara se të fikni marrësin, sigurohuni që të ulni nivelin e volumnit.

Emërtimi i hyrjeve

Ju mund të vendosni një emër deri në 8 karaktere për hyrjet (përveç TUNER) që të shfaqet në panelin e ekranit. Është më e dallueshme që aparatura të emërtohet në ekran sesa foletë.

- 1 Shtypni butonin korrespondues të hyrjes që dëshironi t'i krijoni një emër indeksi.**
Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.
- 2 Shtypni AMP MENU.**
- 3 Shtypni ↑/↓ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur “NAME IN”, më pas shtypni ⊕ ose ➔.**
Kursori pulson dhe ju mund të vendosni një karakter.
- 4 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur një karakter, më pas shtypni ←/➔ për të lëvizur pozicionin e hyrjes prapa dhe përpara.**

Këshilla

- Ju mund të zgjidhni llojin e karakterit si më poshtë duke shtypur ↑/↓.
Alfabeti (shkronjat e mëdha) → Numrat → Simbolet
- Për të vendosur një hapësirë boshe, shtypni ➔ pa zgjedhur një karakter.


Nëse keni bërë një gabim

Shtypni ◀/▶ derisa karakteri që dëshironi të ndryshoni të pulsojë, më pas zgjidhni ▲/▼ për të zgjedhur karakterin e duhur.

5 Shtypni .

Emri që dëshironi është regjistruar.

Paraqitja e informacionit në panelin e ekranit



Kur merrni transmetime RDS (Vetëm modeli evropian)

Emri i shërbimit të programit ose emri i stacionit të paravendosur* → Frekuenca, banda dhe numri i paravendosur → Niveli i volumnit

* Emri i indeksit shfaqet vetëm kur i keni caktuar një të tillë hyrjes ose stacionit të paravendosur (faqe 20, 25). Emri i indeksit nuk shfaqet kur janë vendosur vetëm hapësira boshe, ose është i njëjtë me emrin e hyrjes.

Shënim

Karakteret ose shenjat mund të mos shfaqen për disa gjuhë.

1 Shtypni butonin korrespondues të hyrjes që dëshironi t'i kontrolloni informacionin.

2 Shtypni AMP MENU, më pas shtypni në mënyrë të përsëritur DISPLAY.

Sa herë që shtypni këtë buton, ekrani ndryshon në mënyrë ciklike si më poshtë:

Emri i indeksit të hyrjes* → Hyrja e zgjedhur → Niveli i volumnit

Kur dëgjoni radio FM dhe AM

Emri i stacionit të paravendosur* → Frekuenca, banda dhe numri i paravendosur → Niveli i volumnit

Regjistrimi duke përdorur marrësin

Ju mund të regjistroni tinguj nga një pajisje audio/video duke përdorur marrësin. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e regjistrimit.

1 Shtypni butonin e hyrjes që korrespondon me pajisjen riprodhuese.

Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.

2 Përgatitni pajisjen riprodhuese për luajtje.

Për shembull, vendosni CD-në që dëshironi të kopjoni në luajtësin CD.

3 Përgatitni pajisjen regjistruese.

Futni një MD bosh, kasetë ose videokasetë në pajisjen regjistruese (të lidhur me folëtë MD/TAPE AUDIO OUT ose VIDEO AUDIO OUT).

4 Filloni regjistrimin në pajisjen regjistruese, më pas nisni pajisjen riprodhuese.

Shënime

- Disa burime përmbajnë mbrojtje të drejtave të autorit për të penguar regjistrimin. Në këtë rast, mund të mos jeni në gjendje të regjistroni nga burimi.
- Rregullimet e zërit nuk ndikojnë në daljen e sinjalit nga folëtë MD/TAPE AUDIO OUT ose VIDEO AUDIO OUT.
- Ndërkohë që burimi është duke u regjistruar, mund të fillojë funksioni i gatishmërisë automatike të marrësit dhe mund të ndërpresë regjistrimin. Në këtë rast, vendosni "AUTO.STBY" në "STBY OFF" (faqe 27).
- Ju mund të regjistroni zërin nga pajisja video e lidhur me këtë marrës. Megjithatë, nuk mund ta regjistroni imazhin përmes këtij marrësi.

Funksionet e sintonizuesit

Dëgjimi i radios FM/AM


Ju mund të dëgjoni transmetimet FM dhe AM përmes sintonizuesit të inkorporuar. Përpara përdorimit, sigurohuni që të keni lidhur antenat FM dhe AM (ajrore) me marrësin (faqe 17).

Këshillë

Shkalla e sintonizimit për sintonizim direkt tregohet më poshtë.

Zona	FM	AM
SH.B.A., Kanada	100 kHz	10 kHz*
Evropë	50 kHz	9 kHz

* Shkalla e sintonizimit AM mund të ndryshohet (faqe 24).



Sintonizimi automatik te një stacion (Sintonizimi automatik)

- 1 Shtypni TUNER në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën FM ose AM.**
- 2 Shtypni TUNING + ose TUNING –.**
TUNING + skanon nga stacionet më të ulëta të frekuencës te ato më të lartat dhe TUNING – për të skanuar nga më e lartat te më e ulëtat.
Marrësi ndalon skanimin sa herë që kapet një stacion.

Përdorimi i butonave të kontrollit në marrës

- 1** Rrotulloni INPUT SELECTOR për të zgjedhur bandën FM ose AM.
- 2** Shtypni TUNING MODE në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur “AUTO”.
- 3** Shtypni TUNING + ose TUNING –.

Në rast se ka marrje të dobët stereo FM

Nëse marrja stereo FM është e dobët dhe në panelin e ekranit pulson “ST”, zgjidhni audion mono për të pakësuar distorsionin e zërit. Shtypni FM MODE në mënyrë të përsëritur derisa të ndizet treguesi “MONO” në panelin e ekranit.
Për t'u kthyer në modalitetin stereo, shtypni FM MODE në mënyrë të përsëritur derisa të mos jetë i ndezur treguesi “MONO” në panelin e ekranit.

Sintonizimi direkt te një stacion (Sintonizimi direkt)

Ju mund të vendosni frekuencën e një stacioni direkt duke përdorur butonat e numrave.

- 1 Shtypni TUNER në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën FM ose AM.**
Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.
- 2 Shtypni D.TUNING.**
- 3 Shtypni butonat e numrave për të futur frekuencën.**
Shembull 1: FM 102.50 MHz
 - Vetëm modelet e SH.B.A.-së dhe Kanadasë:
Zgjidhni 1 ➔ 0 ➔ 2 ➔ 5
 - Modelet e tjera:
Zgjidhni 1 ➔ 0 ➔ 2 ➔ 5 ➔ 0Shembull 2: AM 1,350 kHz
Zgjidhni 1 ➔ 3 ➔ 5 ➔ 0

Këshillë

Rregulloni drejtimin e antenës AM në formë kornize (ajrore) për marrje optimale kur sintonizoheni te një stacion AM.

4 Shtypni .


Nëse nuk mund të sintonizoheni te një stacion

Shfaqen “- - - . - - MHz” ose “- - - - kHz” dhe më pas ekrani kthehet në frekuencën aktuale. Sigurohuni që të keni futur frekuencën e duhur. Proveni të përsëritni hapat 2 deri 4. Nëse ende nuk arrini të sintonizoheni te një stacion, frekuenca mund të mos jetë në përdorim në zonën tuaj.

Ndryshimi i shkallës së sintonizimit AM

(Vetëm modelet e SH.B.A.-së dhe Kanadasë)

Ju mund të ndryshoni shkallën e sintonizimit AM në 9 kHz ose 10 kHz duke përdorur butonat në marrës.



- 1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.**
- 2 Ndërkohë që mbani shtypur TUNING MODE, shtypni I/⏻.**
- 3 Ndryshoni shkallën aktuale të sintonizimit AM në 9kHz (ose 10 kHz).**

Për të rivendosur shkallën në 10 kHz (ose 9 kHz), përsëritni procedurën e mësipërme.


Shënim

Të gjitha stacionet e paravendosura do të fshihen kur ndryshoni shkallën e sintonizimit.

Paravendosja e stacioneve të radios FM/AM

(Sintonizimi i paravendosur)

Ju mund të ruani deri në 30 stacione FM dhe 30 stacione AM të preferuara si stacione të paravendosura.



- 1 Shtypni TUNER në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën FM ose AM.**
Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.
- 2 Sintonizohuni te një stacion që dëshironi të paravendosni duke përdorur sintonizimin automatik (faqe 23) ose sintonizimin direkt (faqe 23).**
- 3 Shtypni ENTER/MEMORY.**
Mund të përdorni gjithashtu MEMORY/ENTER te marrësi.
- 4 Shtypni butonat e numrave për të zgjedhur një numër të paravendosur.**
Mund të shtypni gjithashtu PRESET + ose PRESET - për të zgjedhur një numër të paravendosjes.

5 Shtypni .

Stacioni ruhet si numri i zgjedhur i paravendosur.

6 Përsëritni hapat 1 deri 5 për të ruajtur një stacion tjetër.


Sintonizimi te stacionet e paravendosura


1 Shtypni TUNER në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën FM ose AM.

Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.

2 Shtypni PRESET + or PRESET – në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur stacionin.

Sa herë që shtypni këtë buton, mund të zgjidhni një stacion të paravendosur si më poshtë:



Ju mund të shtypni edhe butonat e numrave për të futur një stacion të paravendosur. Për t'u sintonizuar te përzgjedhja, shtypni .

Përdorimi i butonave të kontrollit në marrës

- 1 Rrotulloni INPUT SELECTOR për të zgjedhur bandën FM ose AM.
- 2 Shtypni TUNING MODE në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PRESET".
- 3 Shtypni TUNING + or TUNING – në mënyrë të përsëritur për të paravendosur stacionin që dëshironi.

Emërtimi i stacioneve të paravendosura

1 Shtypni TUNER në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur bandën FM ose AM.

Mund të përdorni gjithashtu INPUT SELECTOR te marrësi.

2 Sintonizohuni te kanali i paravendosur që dëshironi t'i krijoni një emër indeksi (faqe 25).

3 Shtypni AMP MENU.



4 Shtypni në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "NAME IN", më pas shtypni ose .

Kursori pulson dhe ju mund të vendosni një karakter.



5 Shtypni për të zgjedhur një karakter, më pas shtypni për të lëvizur pozicionin e hyrjes prapa dhe përpara.

Ju mund të vendosni deri në 8 karaktere për të emërtuar një stacion.

Këshilla

- Ju mund të zgjidhni llojin e karakterit si më poshtë duke shtypur .
- Alfabeti (shkronjat e mëdha) → Numrat → Simbolet
- Për të vendosur një hapësirë boshe, shtypni  pa zgjedhur një karakter.

Nëse keni bërë një gabim

Shtypni  derisa karakteri që dëshironi të ndryshoni të pulsojë, më pas zgjidhni  për të zgjedhur karakterin e duhur.

6 Shtypni .

Emri që dëshironi është regjistruar.

Shënim (vetëm modeli evropian)

Kur emërtoni një stacion RDS (Radio Data System) dhe sintonizoheni te ai stacion, shfaqet emri i shërbimit të programit në vend të emrit që futët.

Marrja e transmetimeve RDS

(Vetëm modeli evropian)

Ky marrës ju lejon të përdorni Radio Data System (RDS) i cili mundëson stacionet e radios të dërgojnë informacion shtesë përgjatë sinjalit normal të programit. Ky marrës ofron veçori të dobishme, si p.sh. shfaqjen e emrit të shërbimit të programit. RDS është e disponueshme vetëm për stacionet FM.*

* Jo të gjitha stacionet FM ofrojnë shërbim RDS, dhe as nuk ofrojnë të njëjtat lloje shërbimesh. Nëse nuk i njihni mirë shërbimet RDS në zonën tuaj, kontaktoni stacionet të radiove lokale për detaje.

Thjesht zgjidhni një stacion në bandën FM duke përdorur sintonizimin direkt (faqe 23), sintonizimin automatik (faqe 23), ose sintonizimin me stacionin e paravendosur (faqe 25).

Kur sintonizoheni te një stacion që ofron shërbime RDS, "RDS" ndizet dhe në panelin e ekranit shfaqet emri i shërbimit të programit.

Shënim

RDS mund të mos funksionojë mirë nëse stacioni ku jeni sintonizuar nuk e transmeton sinjalin RDS, ose nëse fuqia e sinjalit është e dobët.


Këshillë

Ndërkohë që shfaqet një emër i shërbimit të programit, mund të kontrolloni frekuencën duke shtypur në mënyrë të përsëritur DISPLAY (faqe 21).

Funksionet e menysë

Përdorimi i menysë së cilësimeve

Ju mund të personalizoni marrësin duke kryer rregullime të ndryshme me menyne të cilësimeve.



- 1** Shtypni AMP MENU.
- 2** Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur artikullin e menysë që dëshironi, më pas shtypni \oplus ose \rightarrow .
- 3** Shtypni \uparrow/\downarrow në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur cilësimin që dëshironi, më pas shtypni \oplus .

Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm

Shtypni \leftarrow ose RETURN/EXIT \curvearrowright .

Për të dalë nga menyyja

Shtypni AMP MENU.

Shënim

Disa parametra dhe cilësime mund të shfaqen të zbehta në panelin e ekranit. Kjo do të thotë se ato janë ose të padisponueshme ose fikse dhe të padryshueshme.

Pamje e përgjithshme e menyve

■ BALANCE (Balanca e altoparlantëve)

Ju lejon të rregulloni balancën mes altoparlantëve të majtë dhe të djathtë.

Ju mund të rregulloni BAL. L+10 dB

deri BAL. R+10 me hapa nga 1 dB.

Cilësimi fillestar është BAL. 0.

■ NAME IN (Emërtimi)

Ju lejon të vendosni emrin e hyrjeve dhe stacioneve të paravendosura. Për detaje, shihni “Emërtimi i hyrjeve” (faqe 20) dhe “Emërtimi i stacioneve të paravendosura” (faqe 25).

■ AUTO.STBY (Gatishmëri automatike)

Ju lejon të vendosni çelësin e marrësit automatikisht në modalitetin e gatishmërisë kur nuk e përdorni marrësin ose kur nuk ka hyrje sinjalesh në marrës.

• STBY ON

Kalon në modalitetin e gatishmërisë pas afërsisht 30 minutash.

• STBY OFF

Nuk kalon në modalitet gatishmërie.

Shënime

- Ky funksion nuk funksionon kur zgjidhet hyrja TUNER.
- Nëse përdorni njëkohësisht modalitetin e gatishmërisë automatike dhe kohëmatësin e fjetjes, prioritet ka kohëmatësi i fjetjes.

Përdorimi i telekomandës

Ripërcaktimi i butonit të hyrjes

Ju mund të ndryshoni cilësimet e parazgjedhura të butonave të hyrjes për t’iu përshtatur pajisjes në sistemin tuaj. Për shembull, nëse lidheni me një luajtës Blu-ray Disc me folenë SAT në marrës, mund të vendosni butonin SAT në këtë telekomandë të kontrollonjë edhe luajtësin Blu-ray.

Shënim

Nuk mund të ripërcaktoni butonat e hyrjes TUNER dhe PORTABLE.

1 Mbani shtypur butonin e hyrjes që dëshironi t’i ndryshoni përcaktimin.

Shembull: Mbani shtypur SAT.

2 Duke iu referuar tabelës së mëposhtme, shtypni butonin korrespondues për kategorinë që dëshironi.

Shembull: Shtypni 8.

Tani mund të përdorni butonin SAT për të kontrolluar luajtësin Blu-ray Disc.

Kategoritë dhe butonat korrespondues


Kategoritë	Shtypni
VCR (modaliteti komandues VTR 3) ^{a)}	1
DVD luajtës (modaliteti komandues DVD1)	2
DVD regjistrues (modaliteti komandues DVD3) ^{b)}	3
Luajtës CD	4
Marrës satelitor euro-dixhital	5
DVR (Terminali i televizionit kabllor dixhital)	6
DSS (Marrës satelitor dixhital)	7
Luajtës Blu-ray Disc (modaliteti komandues BD1) ^{c)}	8
Regjistrues Blu-ray Disc (modaliteti komandues BD3) ^{c)}	9
Luajtës MD	0/10
Luajtës kasetash	-/--

a) VCR-të Sony përdoren me një cilësim VTR 3 i cili i korrespondon VHS-së.

b) Regjistruesit DVD Sony përdoren me një cilësim DVD1 ose DVD3. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me regjistruesit DVD.

c) Për detaje mbi cilësimet BD1 ose BD3, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me luajtësin Blue-ray Disc ose regjistruesin Blue-ray Disc.

Ripërcaktimi i butonave të hyrjes



1 Ndërkohë që mbani shtypur **MASTER VOL -**, shtypni **1/2** dhe **TV INPUT**.

2 Lëshoni të gjithë butonat.

Butonat e hyrjes rivendosen në cilësimin e parazgjedhur.

Masat paraprake

Mbi sigurinë

Nëse brenda në mobilie bie diçka e fortë ose lëng, marrësi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.

Mbi burimet e rrymës

- Përpara se të përdorni marrësin, kontrolloni që tensioni i përdorimit të jetë identik me furnizimin vendas me energji. Tensioni i përdorimit tregohet në pllakëzën metalike në pjesën e pasme të marrësit.
- Njësia nuk shkëputet nga burimi i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) për sa kohë që është e lidhur me prizën e murit, edhe nëse njësia vetë është e fikur.
- Nëse nuk do ta përdorni marrësin për një kohë të gjatë, sigurohuni që ta shkëputni marrësin nga priza e murit. Për të shkëputur kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), kapeni te vetë priza; mos tërhiqni asnjëherë kordonin.
- Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) duhet të zëvendësohet vetëm nga një dyqan servisi i kualifikuar.
- (Vetëm modelet e SH.B.A.-së dhe Kanadasë) Një kunj i spinës është më i gjerë se tjetri për qëllim sigurie dhe do të futet në prizën e murit vetëm në një mënyrë. Nëse nuk jeni në gjendje ta futni spinën plotësisht në prizë, kontaktoni me shitësin.

Mbi akumulimin e nxehtësisë

Megjithëse marrësi nxehet gjatë punës, ky nuk është keqfunktionim. Nëse e përdorni këtë marrës vazhdimisht me volum të lartë, temperatura e kabinetit të pjesës së sipërme, anësore dhe të poshtme, rritet në mënyrë të konsiderueshme. Për të shmangur djegien, mos e prekni kabinetin.

Mbi vendosjen

- Vendoseni marrësin në një vend me ajrosje të mjaftueshme për të parandaluar akumulimin e nxehtësisë dhe për të shtuar jetëgjatësinë e marrësit.
- Mos e vendosni marrësin pranë burimeve të nxehtësisë siç janë radiatorët, tubacionet e ajrit, ose në një vend ku bie drita e drejtpërdrejtë e diellit, ku ka pluhur të tepërt, ose tronditje mekanike.
- Mos vendosni asgjë mbi pjesën e sipërme të kabinetit që mund të bllokojë vrimat e ajrimit dhe të shkaktojë keqfunktionime.
- Mos e vendosni marrësin pranë pajisjeve të tilla si televizorë, VCR ose magnetofona. (Nëse marrësi përdoret në kombinim me një televizor, VCR, ose magnetofon, dhe vendoset shumë pranë asaj pajisjeje, mund të krijohen zhurma dhe mund të prishet cilësia e figurës. Kjo mund të ndodh sidomos kur përdorni një antenë të brendshme (ajrore). Për këtë arsye, rekomandojmë që të përdorni një antenë të jashtme (ajrore).)
- Kini kujdes kur vendosni marrësin mbi dysheme me trajtim të veçantë (të trajtuara me dyllë, vaj, me lustër, etj.), duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.

Mbi përdorimin

Përpara se të lidhni pajisje të tjera, sigurohuni që të fikni dhe hiqni nga priza marrësin.

Mbi pastrimin

Pastroni mobilien, panelin dhe kontrollet me një pëlthurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me marrësin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të marrësit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkontë riparime. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony. Vini re se nëse personeli i shërbimit ndërron disa pjesë gjatë riparimit, ata mund t'i mbajnë këto pjesë.

Energjia

Marrësi fiket automatikisht.

- “AUTO.STBY” vendoset në “STBY ON” (faqe 27).
- Funkcioni i kohëmatësit të fjetjes është në punë (faqe 11).

Zëri

Një nga altoparlantët nuk lëshon zë.

- Lidhni një palë kufje me folenë PHONES për të verifikuar që nga kufjet del zë. Nëse nga kufjet del vetëm një kanal, pajisja mund të mos jetë lidhur saktë me marrësin. Kontrolloni që të gjithë kordonët të jetë futur plotësisht në marrës dhe në pajisje. Nëse nga kufjet dalin të dy kanalet, altoparlati mund të mos jetë lidhur saktë me marrësin. Kontrolloni lidhjen e altoparlatit që nuk nxjerr zë.
- Sigurohuni që ta keni lidhur me të dyja foletë L dhe R të një pajisjeje analoge, pajisja analoge kërkon të dyja lidhjet L dhe R. Përdorni një kordon audio (nuk jepet).

Një pajisje specifike nuk lëshon zë.

- Kontrolloni që pajisja të jetë lidhur saktë me foletë e hyrjes audio për atë pajisje.
- Kontrolloni që kordoni (ose kordonët) i përdorur për lidhjen të jetë futur plotësisht në marrës dhe në pajisje.

Nuk del zë ose një zë shumë i ulët, pavarësisht se cila pajisje zgjidhet.

- Kontrolloni që të gjithë kordonët të jenë futur në foletë e tyre të hyrjes/daljes për foletë përkatëse të marrësit, altoparlantëve dhe pajisjes.
- Kontrolloni që marrësi dhe të gjitha pajisjet të jenë ndezur.
- Kontrolloni që MASTER VOLUME të mos jetë vendosur në “VOL MIN”.
- Kontrolloni që SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) të mos jetë vendosur në “OFF”.
- Kontrolloni që kufjet të mos jenë lidhur.
- Shtypni MUTING për të anuluar funksionin e heshtjes.
- Provoni të shtypni butonin e hyrjes në telekomandë ose të rrotulloni INPUT SELECTOR në marrës për të zgjedhur pajisjen që ju zgjidhni (faqe 20).
- Pajisja mbrojtëse në marrës është aktivizuar. Fikni marrësin, eliminoni problemin e qarkut të shkurtër, dhe ndizeni sërish.

Ka gumëzhitje ose zhurmë të madhe.

- Kontrolloni që altoparlantët dhe pajisjet të jenë lidhur mirë.
- Kontrolloni që kordonët e lidhjes të jenë larg nga transformatori ose motori, dhe të paktën 3 metra (10 këmbë) larg nga një televizori ose dritë fluoreshente.
- Lëvizini pajisjen audio tuaj larg nga televizori.
- Fishat dhe foletë janë të papastra. Fshijini me një copë të lyer paksa me alkool.

Zëri majtas dhe djathtas është i pabalancuar ose i ndryshuar.

- Kontrolloni që altoparlantët dhe pajisjet të jenë lidhur saktë dhe mirë.
- Rregullon balancën e altoparlantëve (faqe 27).

Nga pajisja e lidhur me folenë PORTABLE IN, del gumëzhitje e fortë, zhurmë e ndërprerë ose distorsion.

- Kontrolloni që pajisjet të jenë lidhur mirë.
- Ky nuk është keqfunksionim dhe do të varet nga pajisja e lidhur.

Regjistrimi nuk mund të kryhet.

- Kontrolloni që pajisjet të jenë lidhur saktë.
 - Zgjidhni pajisjen burimore duke përdorur butonat e hyrjes (faqe 20).
 - Burimet përmbajnë mbrojtje të drejtave të autorit për të penguar regjistrimin. Në këtë rast, mund të mos jeni në gjendje të regjistroni nga burimet.
-

Sintonizuesi


Funksioni i sintonizuesit nuk mund të zgjidhet.

- Kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.
-

Marrja FM është e dobët.

- Përdorni një kabllo koaksiale 75-om (nuk jepet) për të lidhur marrësin me një antenë FM të jashtme (ajrore) siç tregohet më poshtë.

Antena FM e jashtme (ajrore)



Stacionet e radios nuk mund të sintonizohen.

- Kontrolloni që antenat (ajrore) të jenë lidhur mirë. Rregulloni antenat (ajrore) dhe lidhni një antenë të jashtme (ajrore) nëse është e nevojshme.
 - Forca e sinjalit të stacioneve është tepër e dobët me sintonizimin automatik. Përdorni sintonizimin direkt.
 - Sigurohuni që të vendosni saktë shkallën e sintonizimit (kur sintonizoni stacionet AM me sintonizim direkt) (faqe 23).
 - Nuk është vendosur asnjë stacion ose stacionet e paravendosura janë fshirë (kur përdoret sintonizimi duke skanuar stacionet e paravendosura). Paravendosni stacionet (faqe 24).
 - Shtypni DISPLAY vazhdimisht në mënyrë që frekuenca të shfaqet në panelin e ekranit.
-

RDS nuk funksionon.*

- Sigurohuni që të jeni sintonizuar te një kanal FM RDS.
 - Zgjidhni një stacion më të fortë FM.
 - Stacioni ku jeni sintonizuar nuk e transmeton sinjalin RDS, ose fuqia e sinjalit është e dobët.
-

Informacioni RDS që dëshironi nuk shfaqet.*

- Shërbimi mund të jetë përkohësisht jashtë shërbimit. Kontaktoni me stacionin e radios dhe informohuni nëse e ofrojnë në të vërtetë shërbimin në fjalë.
-

* Vetëm modeli evropian.

Telekomanda

Telekomanda nuk funksionon.

- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës në marrës.
- Largoni çdo pengesë mes telekomandës dhe marrësit.
- Zëvendësoni të gjitha bateritë në telekomandë me të reja, nëse janë të shkarkuara.
- Sigurohuni që të zgjidhni hyrjen e saktë në telekomandë.

Mesazhet e gabimit

Nëse ka keqfunksionim, shfaqet një mesazh në panelin e ekranit. Mund të kontrolloni gjendjen e mesazhit me këtë mesazh. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

PROTECT

Në altoparantë del rrymë e parregullt, ose marrësi është i mbuluar dhe vrimat e ventilimit janë të bllokuara. Marrësi do të fiket automatikisht pas pak sekondash. Kontrolloni lidhjen e altoparantit dhe ndizeni sërish.

Pastrimi i memories

Paragrafi i referencave

Për të pastruar	Shihni
Të gjitha cilësimet e memorizuara	faqe 18

Specifikimet

SPECIFIKIMET E FUQISË AUDIO

DALJA E FUQISË DHE DISTORSIONI TOTAL HARMONIK:

(Vetëm modeli i SH.B.A.)

Me ngarkesa 8 om, me të dyja kanalet në funksionim, nga 20 – 20,000 Hz; 90 vat nominale për fuqi minimale RMS në kanal, me jo më pak se 0.09% distorsion total harmonik nga 250 milivat në dalje nominale.

Seksioni i amplifikatorit

Modelet e SH.B.A.-së, Evropës dhe Kanadasë¹⁾

Fuqia minimale e daljes RMS (8 om, 20 Hz – 20 kHz, THD 0.09%)

90 W + 90 W

Fuqia e daljes në modalitetin stereo (8 om, 1 kHz, THD 1%)

100 W + 100 W

¹⁾Matur në kushtet e mëposhtme:

Zona	Furnizimi me energji
SH.B.A., Kanada	120 V AC, 60 Hz
Evropë	230 V AC, 50 Hz

Reagimi i frekuencës

Analoge 10 Hz – 70 kHz
+0.5/-2 dB (me BASS = 0 dB, TREBLE = 0 dB)

Hyrje

Analoge (PORTABLE IN)
Ndjeshmëria: 1 V/
50 kilo om
S/N²⁾: 96 dB (A, 500 mV³⁾)

Hyrjet

Analoge (Përveç PORTABLE IN)
Ndjeshmëria: 500 mV/
50 kilo oms
S/N²⁾: 96 dB (A, 500 mV³⁾)

Daljet

Analoge (AUDIO OUT)
Tensioni: 500 mV/
10 kilo oms

Toni

Nivelet e përforcimit

± 10 dB, hapa nga 1 dB

²⁾ INPUT SHORT (me BASS = 0 dB,
TREBLE = 0 dB).

³⁾ Rrjeti i vlerësuar, niveli i hyrjes.

Seksioni i sintonizuesit FM

Diapazoni i sintonizimit

87.5 MHz – 108.0 MHz

Antena (ajrore) Antena FM me tel (ajrore)

Terminalet e antenës (ajrore)

75 om, pabalancuar

Seksioni i sintonizuesit AM

Diapazoni i sintonizimit

Zona	Shkalla e sintonizimit	
	Hapa nga 10 kHz	Hapa nga 9 kHz
SH.B.A., Kanada	530 kHz – 1,710 kHz	531 kHz – 1,710 kHz
Evropë	–	531 kHz – 1,602 kHz

Antena (ajrore) Antena në formë kornize
(ajrore)

Të përgjithshme

Furnizimi me energji

Zona	Furnizimi me energji
SH.B.A., Kanada	120 V AC, 60 Hz
Evropë	230 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë 200 W

Konsumi i energjisë (gjatë modalitetit

në gatishmëri) 0.3 W

Përmasat (gj/l/th) (afërsisht)

430 mm × 132.5 mm ×
279 mm (17 inç × 5 1/4 inç
× 11 inç) përfshirë pjesët
projektuese dhe kontrollet

Masa (afërsisht) 6.4 kg (14 lb 2 oz)

Dizajni dhe specifikimet janë subjekt
ndryshimi pa dhënë njoftim.

Zjarrfrenuesit halogjenë nuk përdoren në
disa qarqe të printuara elektrike.

Indeksi

A

Altoparlantët
 instalimi 13
 lidhja 14
AUTO.STBY 27

B

BALANCE 27
BASS 19

C

Cilësimi fillestar 18

E

Emërtimi
 i hyrjeve 20
 i stacioneve të
 paravendosura 25

H

Heshtja 20

K

Kohëmatësi i fjetjes 11

L

Luajtës Blu-ray Disc
 lidhja 16
Luajtës CD
 lidhja 14
Luajtës DVD
 lidhja 16
Luajtës kasetash
 lidhja 14
Luajtës MD
 lidhja 14
Luajtës Super Audio CD
 lidhja 14

M

Mesazhet e gabimit 32

P

Pastro
 memoria 18
 telekomanda 28

R

RDS 26
Regjistrimi 22
Regjistrues DVD
 lidhja 16

S

Sintonizimi
 automatik 23
 direkt 23
 te stacionet e
 paravendosura 25
Sintonizues satelitor
 lidhja 16
Sintonizues televizioni
 kabllor
 lidhja 16
Sintonizuesi
 lidhja 17

T

Telekomanda 10
TREBLE 19

V

VCR
 lidhja 16

<http://www.sony.net/>

©2012 Sony Corporation



* 4 2 9 4 4 7 2 1 1 * (1)